



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 102, Datë 12.05.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“DIMAX ALBANIA” SH.P.K. PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR
TRANSFERIMIN (NËPËRMJET KONTRATËS SË HIPOTEKËS) TË ASETEVE
FIKSE TË SAJ**

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 2, gërma “a”, 3, 4, gërmat “a” dhe “b”, 5, gërma “j”, 6, 7 dhe 8 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.07.2016; neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.05.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1591/2 prot., datë 08.05.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “DIMAX ALBANIA” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet kontratës së hipotekës) të aseteve fikse të saj”,

Konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës dhe barrës siguroese kolaterali financiar) të aseteve të shoqërisë “DIMAX ALBANIA” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si më poshtë vijon:

1. Kërkesa për Marrjen e Autorizimit

- Shoqëria “DIMAX ALBANIA” sh.p.k është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhimi 2 MW, në Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 308, datë 30.11.2022, për një afat 25-vjeçar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1591 prot., datë 23.04.2025, ajo ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të shoqërisë “DIMAX ALBANIA” sh.p.k, në favor të “Raiffeisen Bank sh.a.

2. Shqyrtimi i Kërkesës dhe Dokumentacionit të Paraqitur

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe të neneve 2, gërma “a”, 3, 5, gërma “j” dhe 6 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me

vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, rezulton se ERE miraton kërkesat e të licencuarave për transferimin e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Neni 7, Pika 1

- **gërma “a”** Shoqëria duhet të sjellë ekstraktin historik të saj.
- **gërma “c”** Shoqëria duhet të bëjë me dije në lidhje me gjendjen financiare të saj dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve.
- **gërma “d”** Shoqërisë duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e kërkuar nga kjo pikë e rregullores në lidhje me kandidatin e propozuar për transferimin e aseteve.
- **gërma “e”** Shoqëria duhet të informojë në lidhje me garantimin e shlyerjes së kredisë si dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike.
- **gërma “h”** Shoqëria duhet të depozitojë listën e detajuar të aseteve fikse (me vlerat specifike dhe totale të tyre) e cila duhet të jetë pjesë përbërëse e Kontratës së Hipotekës, që i shërben veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike dhe ta depozitojë këtë të fundit në ERE. Gjithashtu në vijim, kërkohet sqarim nga shoqëria “HYDROPOWER” sh.p.k. në lidhje me cilësinë e saj si bashkëkredimarrëse, në funksion të përcaktimeve të kontratës së kredisë.
- **gërma “j”**: Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka patur transferime të kryera më herët nga ana saj.
- **Pika 6:** Shoqëria nuk ka bërë me dije nëse ka pjesë të dokumentacionit të përcjellë që kërkon të mos jetë e hapur për publikun, ndaj do t’i kërkohet kjo në vijim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “DIMAX ALBANIA” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj “Raiffesisen Bank” sh.a., që rrjedhin nga kontrata e kredisë e nr. 5472 rep., nr. 1483 kol., datë 23.08.2023, të lidhur ndërmjet palëve.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “DIMAX ALBANIA” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
PetrIT AHMETI